

**L I G J**  
**Nr. 8922, datë 22.7.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR SIGURIMIN E  
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR” NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE NATO-S”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe NATO-s”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3421, datë 7.8.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE SIGURIMI**

Qeveria e Shqipërisë, e përfaqësuar nga gjeneral Leitnant Ilia VASHO,  
oficer i përhershëm ndërlidhës në shtabin e NATO-s;  
NATO, e përfaqësuar nga Dr. Manfred Wörner,  
Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s;  
Meqenëse Republika e Shqipërisë është një vend partner i Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC) / Partneritetit për Paqe (PfP);

Meqenëse është rënë dakord që të konsultohet për një çështje politike dhe çështje që lidhen me sigurimin, të zgjerohet dhe të intensifikohet bashkëpunimin politik e ushtarak në Europë;

Meqenëse bashkëpunimi efektiv në këto çështje kërkon shkëmbimin e informacionit sensitiv apo të privilegjuar ndërmjet Palëve;

U ra dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët:

(i) do të mbrojnë dhe sigurojnë informacionin dhe materialin e Palës tjetër;

(ii) do të bëjnë çdo përpjekje që, në qoftë se ai është i klasifikuar, ky informacion dhe material do të ruajë klasifikimet e sigurisë të vendosura nga ndonjë Palë, në përputhje me origjinën e informacionit dhe materialit të asaj Pale dhe të sigurojnë informacionin dhe materialin sipas standardeve të aprovuara;

(iii) të mos e përdorin informacionin dhe materialin e shkëmbyer për qëllime të tjera, përveç atyre të vendosura në kuadrin e programeve respektive, vendimeve dhe rezolutave që i referohen këtyre programeve;

(iv) të mos ia japin këtë informacion dhe material Palëve të treta pa miratimin e prodhuesit origjinal.

## Neni 2

(i) Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon angazhimin që të gjithë personat e nacionalitetit të saj, të cilët, në kryerjen detyrave të tyre zyrtare kërkojnë ose mund të kenë akses në materialin apo informacionin e shkëmbyer sipas programeve të NACC-së apo PFP, të jenë të certifikuar përpara se atyre t'u jepet akses në këtë material dhe informacion.

(ii) Procedurat e certifikimit duhet të jenë të tilla që të përcaktojnë se kur një invalid, duke patur parasysh besnikërinë dhe besueshmërinë e tij mund të ketë akses tek informacioni i klasifikuar pa rrezikuar sigurinë e këtij informacioni.

## Neni 3

Zyra e Sigurimit të NATO-s (NOS), nën drejtimin dhe në emër të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kryetarit, Komitetit Ushtarak të NATO-s, duke vepruar në emër të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe Komitetit Ushtarak të NATO-s dhe nën autoritetin e tyre, përgjigjet për marrjen e masave të sigurimit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer brenda bashkëpunimit NACC/PFP.

## Neni 4

Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të informojë Zyrën e Sigurimit të NATO-s me të njëjtën përgjegjësi kombëtare. Arranxhime administrative të veçanta do të bëhen ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe NATO-s, të cilët do të mbulojnë standardet reciproke të sigurimit të informacionit të shkëmbyer ndërmjet Autoritetit të Sigurimit të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Sigurimit të NATO-s.

## Neni 5

Përpara shkëmbimit të informacionit të klasifikuar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe NATO-s, autoritetet përgjegjëse të sigurimit, reciprokisht, duhet të sigurojnë njëri-tjetrin, se Pala marrëse është e përgatitur të mbrojë informacionin e marrë, siç kërkohet nga prodhuesi origjinal.

Përfaqësuesit e përmendur më sipër nënshkruan Marrëveshjen prezente.

Marrëveshja, e shkruar në dy kopje në gjuhët anglisht dhe frëngjisht me përmbajtje plotësisht të njëjtë, u firmos në Bruksel më 26 korrik 1994.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Për NATO-n

Gjeneral Leitnant  
Ilia Vasho

Dr. Manfred Wörner

KODI I SJELLJES (Code of Conduct)  
Qeveria e Republikës së Shqipërisë,  
e përfaqësuar nga  
Gjenerali i Leitnant Ilia Vasho,  
oficer ndërlidhës i përhershëm në shtabin e NATO-s

Duke pasur parasysh, se brenda kuadrit të aktiviteteve të Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut/Partneritetit për Paqe, Shtetet Partnere janë ftuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut të marrin pjesë në misionet politike e ushtarake të Shtabit të NATO-s dhe në Zyrën e Koordinimit të Partneritetit të Mons (Belgjikë).

Duke pasur parasysh, se Këshilli i Atlantikut të Veriut ka kërkuar që shtetet partnere të mos shfrytëzojnë fasilitetet e dhëna nga NATO për aktivitete të tjera, që nuk përputhen me principet e bashkëpunimit në kuadrin e partneritetit, dhe/ose dëmtojnë interesat kombëtare të vendeve anëtare të Aleancës.

Në lidhje me këtë deklaron angazhimin e saj.

Ky "kod sjelljeje" është firmosur nga diplomati me autoritet të plotë.

Marrëveshja, e shkruar në dy kopje në gjuhët anglisht dhe frëngjisht me përmbajtje plotësisht të njëjtë, u firmos në Bruksel më 26 korrik 1994.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë  
Gjeneral Leitnant Ilia Vasho